



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

INSPEKTORATI SHTETËROR SHËNDETËSOR
DREJTORIA E KOORDINIMIT DHE MONITORIMIT TË INSPEKTIMIT

Tiranë, më 31 janar 2024

Lënda: Kthim përgjigje “Kërkesë për informacion”.

ESMERALDA KETA
FAKTOJE
TIRANË

Në përgjigje të kërkesës Suaj për informacion dërguar me email më datë 23.01.2024, Ju informojmë si më poshtë vijon:

Baza ligjore dhe kompetencat mbi të cilat ushtron aktivitetin ISHSH nuk përfshijnë licensimin e asnjë lloj veprimtarie apo subjekti.

Bazuar në Nenin 27 të Ligjit 10 107, datë. 30.03.2009 “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, licencimi dhe rilicencimi është proces i detyrueshëm për personat fizikë ose juridikë, që ofrojnë shërbime shëndetësore në Republikën e Shqipërisë. Neni 38 përcakton se “Shkelja e nenit 27 të këtij ligji nga personat fizikë ose juridikë, publikë ose privatë, që ofrojnë kujdes shëndetësor në Republikën e Shqipërisë, dënohet me gjobë 500 000 lekë dhe, në rast përsëritjeje, me 5-fishin e gjobës dhe denoncim në organet kompetente”.

ISHSH kryen inspektime bazuar në Ligjin Nr. 10 433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”. Inspektimi mund të kryhet vetëm në zbatim të programit të inspektimit, përjashtimisht një subjekt mund të inspektohet jashtë programit në rastet e parashikuara në ligjin “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” ku parashikohen inspektim në kushte flagrance, denoncime, ankesa, urdher Ministri/Kryeinspetori etj. Programi vjetor i inspektimit hartohet mbi bazë tematikash nga Drejtoria e Koordinimit dhe Monitorimit të Inspektimit pranë ISHSH qendror dhe më pas programet mujore hartohen nga ISHSH rajonale me subjekte konkrete që ushtrojnë aktivitetet në përputhje me tematikat inspektuese vjetore, të cilat merren në databazën e ISHSH apo në Qendrën Kombëtare të Biznesit, QKB.

Në subjektin Klinika “Splendent”, regjistruar në QKB si person fizik Ina Xhaxho, NIPT L82307001G, është kryer inspektimi dhe auditimi klinik në datat 12 dhe 13 tetor 2023, në bazë të Urdhër Nr. 632, datë 10.10.2023 të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale “Për ngritjen e

grupit për verifikimin e përmbushjes së standardeve të ofrimit të shërbimit shëndetësor në Klinikën “Splendent”.

ISHSH konstatoi se subjekti nuk ishte i pajisur me licencë për ushtrimin e aktivitetit shërbime mjekësore dhe/ose stomatologjike kategoria II. 6 A.3 kabinet dentar. Ndaj subjektit I. Xh. NIPT L82307001G është vendosur më datë 13 tetor 2023 masë administrative, 500 000 Lekë, për shkelje të pika 1, neni 27 të Ligjit 10 107, datë. 30.03.2009 “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Inspektorati Shtetëror Shëndetësor gjatë vitit 2023 ka kryer 62 inspektime dhe ri-inspektime për plotësimin e standardeve të cilësisë, sigurisë dhe akreditimit të institucioneve shëndetësore.

Bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 865, datë 24.12.2019 “Për mënyrën e kryerjes së Procesit të Akreditimit të institucioneve të kujdesit shëndetësor e përcaktimin e Tarifave dhe afateve kohore”, “Grupet e inspektimit verifikojnë pranë institucioneve të kujdesit shëndetësor përmbushjen e standardeve bazë të akreditimit, të miratuara nga ministri dhe hartojnë raportin përkatës me institucionet që kanë përmbushur ose jo standardet bazë të akreditimit. Ky raport dërgohet pranë ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë dhe institucionit përgjegjës për akreditimin e institucioneve të kujdesit shëndetësor”.

Ju faleminderit